

Shtojca 16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

Nr. 2307/Prot
1

Vlorë, më 22 / 07 /2015

KUSHTET E VEÇANTA

Punët – Proçedura e Hapur
“PIKË PANORAMIKE DHE SPORTIVE NË LLOGARA”

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Kontraktuesi duhet të realizojë Punët ashtu siç janë specifikuar në Kushtet e Përgjithëshme, Kushtet e Veçanta, Formularin e Sigurimit të Kontratë, Njoftimin e Fituesit nga Autoriteti Kontraktor si dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor (dosja e prokuruar elektronikisht) për të cilat kontraktuesi ka dhënë ofertën e tij.

Neni 1: Përkufizime


- 1.1 Autoriteti Kontraktor është : *Këshilli i Qarkut Vlorë*
- 1.2 Kontraktori është : *AVDULI Sh.p.k*

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej *1 581 986 (një milion pesëqind e tetëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekë (10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: *jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve.*

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: *një prej drejtuesëve teknik që ndodhen në liçencën e shoqërisë*
- 3.2 Adresa/pika e kontaktit: *“AVDULI“ Sh.p.k, Vlorë, Lagjja “Hajro Çakërri“, pranë ish Fabrikës së Çimentos*



Neni 4: Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i vendndodhjes së objektit që do të realizohet): *Objekti i përcaktuar sipas projekt – preventivit bashkangjitur DST-së, Llogara, Vlorë*

Neni 5 Data e Fillimit

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: *duke filluar nga njoftimi i Autoritetit Kontraktor me shkrim për lirim e sheshit të ndërtimit. Përpara këtij njoftimi Kontraktori (shoqëria që do të kryejë punimet)nuk ka asnjë të drejtë ligjore të marri masa për fillimin e punimeve.*

Neni 6: Siguracioni

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

- a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: _____
- b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: _____
- c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____
- d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: _____

Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë:

1. *Kontrollin e vazhdueshëm të drejtuesit të projektit.*
2. *Proçes verbalit me shkrim nga ana e Autoritetit Kontraktor, raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës.*
3. *Kontrollet e kërkuara me shkrim nga mbikëqyrësi i punimeve*

Neni 8: Lloji i Kontratës

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një


Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi

Kontratë me Shumë Totale

Neni 9: Grafiku i Pagesës

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: *me dorëzimin e situacioneve pjesore si dhe likuidimi do të bëhet në dy vite 2015 dhe 2016 sipas vlerave të përcaktuara në Formularin e Njoftimit të Kontratës.*

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda *30(tridhjetë)* ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i



konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

- 9.3 Monedha e pagesës do të jetë **LEK**. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10. Pagesa Paraprake

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda _____ ditëve nga marrja e sigurimit të kontrates.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme: _____

Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të lidhura

Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

Autoriteti Kontraktor

Këshilli i Qarkut Vlorë

Z.Sadrit DANAJ

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Vula:

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
**Sheshi "4 Heronjtë",
Rruga "Osman Haxhiu", Vlorë**

Tel: 033 421 601

Kontraktuesi

"AVDULI" Sh.p.k

Z. Arben AVDULI

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Vula:

Adresa: "AVDULI" Sh.p.k
**Lagjja "Hajro Çakërrri", pranë ish
Fabrikës së Çimentos, Vlorë**

Tel: 069 670 4781